

VENDIM
Nr.566, datë 23.8.2006

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË KTHIMIT DHE
KOMPENSIMIT TË PRONAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, 16 e 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Republikën e Shqipërisë, më poshtë e quajtur AKKP-ja, është person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

2. AKKP-ja ka zyrën qendrore në Tiranë dhe 12 zyra rajonale në qarqe. Kjo agjenci, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është e hapur për publikun dhe në shërbim të subjekteve të shpronësuara a të trashëgimtarëve të tyre, gjatë gjithë orarit zyrtar të punës. Çdo kufizim brenda orarit zyrtar, për aplikim, shtim/korrigjim dokumentacioni, takim, këshillim, me punonjësit e agjencisë, përcaktohet me urdhër të brendshëm të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së.

3. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë, e përcaktuara në nenet 15 e 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

4. Organika dhe struktura e AKKP-së (zyra qendrore dhe zyrat rajonale) përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave".

5. AKKP-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 (dy) zëvendës drejtorë.

5/1. Drejtori i Përgjithshëm, përveç detyrave dhe përgjegjësi të parashikuara në ligj, ushtron dhe këto përgjegjësi:

a) Përfaqëson dhe drejton agjencinë;

b) U kërkon drejtuesve rajonalë shpjegime, relitime dhe verifikime administrative, për çështjet që ata mbulojnë;

c) Pezullon zbatimin e akteve të brendshme të drejtuesve rajonalë, me nismën e vet ose me kërkesë të subjekteve të interesuara, kur vëren shkelje të ligjeve, të akteve të Këshillit të Ministrave ose akteve, mbi të cilat mbështetet funksionimi i kësaj agjencie;

ç) Raporton, informon dhe i relatton për veprimtarinë e agjencisë ministrit të Drejtësisë, si dhe zbaton udhëzimet e tij;

d) Raporton në institucionet kushtetuese, sipas këtij vendimi.

5/2. Dy zëvendës drejtorët drejojnë, përkatësisht, në nivel kombëtar, strukturat e mëposhtme:

a) Drejtorinë e Kthimit të Pronave, përgjegjëse për shqyrtimin, ndjekjen dhe zgjidhjen, sipas ligjit, të kërkesave të subjekteve të shpronësuara, përditësimin e të dhënave në regjistr për çështjet e shqyrtuara (njohje, kthim a kompensim pronash), regjistrimin pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendimeve, ku disponohet, në favor të subjektit të shpronësuar, e drejta e pronësisë për pasuri të paluajtshme apo të drejta reale të lidhura me to, si dhe çdo detyrë tjetër, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i agjencisë.

b) Drejtorinë e Kompensimit të Pronave, përgjegjëse për evidentimin e subjekteve dhe përgatitjen e të dhënave të regjistrit për subjektet e shpronësuara, që përfitojnë kompensim, sipas këtij ligji, përlogaritjen e faturës financiare, administrimin dhe shpërndarjen, sipas ligjit, të fondit të kompensimit, të vënë në dispozicion, si dhe çdo detyrë tjetër, të caktuar nga drejtori i Përgjithshëm i agjencisë .

6. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, ndërsa 2 zëvendës drejtorët emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Drejtori i Përgjithshëm dhe 2 zëvendës drejtorët e agjencisë propozohen nga radhët e personave të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe integritet të lartë personal.

Kryeministri, në urdhrin e emërimit, përcakton zëvendës drejtorin përgjegjës, i cili në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm, ka të drejtën të ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë, për përfaqësimin e AKKP-së,

për çështjet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, të ndryshuar.

7. Drejtuesit e zyrave rajonale emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga detyra nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë. Ata përzgjidhen ndërmjet kandidatëve, shtetas shqiptarë, të aftë profesionalisht, me përvojë në drejtim dhe me integritet të lartë personal.

8. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së apo të drejtorit të zyrës rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave, në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, ushtrohen kur vendi mbetet vakant për më shumë se 10 ditë kalendarike, drejtpërdrejt, sipas nenit 34 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nga zëvendës drejtori, që mban këtë tagër në urdhrin e emërimit të tij në detyrë.

Në çdo rast, AKKP-ja evidenton, në regjistrat e veta, në mënyrë të saktë, periudhën e zëvendësimit dhe e bën publike për çdo të interesuar, duke e vendosur edhe në faqen e internetit të agjencisë. Ky informacion përditësohet çdo javë.

Për çdo detyrë a përgjegjësi tjetër, zëvendësimi a delegimi i përgjegjësive kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Drejtori i Përgjithshëm i raporton, me shkrim, periodikisht, çdo tre muaj, Kryeministrit dhe Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financën, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Raporti përmban:

- a) të dhënat e përgjithshme për ecurinë e procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave dhe mbarëvajtjen e tij, si dhe detyrimin për të raportuar për sipërfaqen dhe vlerën në lekë;
- b) numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara, të ndara në nivel qarku dhe në shkallë vendi, si dhe llojin e pasurisë;
- c) numrin e kërkesave të shqyrtuara në zyrat rajonale, raportet e kthimit dhe kompensimit, indeksin e saktë të çështjeve të pranuar a të rrëzuara, si dhe numrin e çështjeve të ankimuara në zyrën qendrore;
- ç) numrin e kompensimeve, të kryera nga zyra qendrore;
- d) numrin e ankimeve, të shqyrtuara nga Drejtori i Përgjithshëm, si dhe indeksin e çështjeve, për të cilat është vendosur pranimi i ankimit, rrëzimi apo zgjidhja në themel;
- dh) numrin e vendimeve të formës së prerë;
- e) të dhënat për nivelin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore;
- ë) indeksin e rasteve të ankimit gjyqësor;
- f) të dhënat për politikën e ndjekur nga agjencia, për çështje të kontrollit të ligjshmërisë, luftës kundër korrupsionit, konfliktit të interesit, mitmarrjes apo favorizimeve të tjera, të paligjshme;
- g) të dhënat për trajtimin e denoncimeve nga qytetarët;
- gj) të dhënat për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të Përgjithshëm, duhet të vihet në dijeni Kryeministri dhe/apo komisioni përkatës i Kuvendit.

Të dhënat e përcaktuara nga shkronja “a” deri në shkronjën “g” dhe të dhënat e tjera, që kanë lidhje me procesin e njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, për subjektet e shpronësuara, bëhen publike në faqen elektronike të agjencisë brenda 2 javësh nga dorëzimi i raportit.

10. Drejtori i zyrës rajonale u raporton me shkrim, çdo muaj, Drejtorit të Përgjithshëm dhe prefektit të qarkut. Raporti përmban:

- a) të dhënat e përgjithshme për ecurinë e procesit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave në qark dhe për mbarëvajtjen e këtij procesi, si dhe detyrimin për të raportuar për sipërfaqen dhe vlerën në lekë;
- b) numrin e kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara dhe llojin e pasurisë, objekt kërkimi;
- c) numrin e kërkesave të shqyrtuara dhe raportet e kthimit dhe të kompensimit, indeksin e saktë të çështjeve të pranuar a të rrëzuara, si dhe numrin e çështjeve të ankimuara në zyrën qendrore;
- ç) të dhëna për nivelin e bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore të qarkut;
- d) indeksin e rasteve të ankimit gjyqësor;
- e) të dhëna për çdo çështje tjetër, për të cilën kërkohet informacion apo që, sipas vlerësimit të drejtorit të zyrës rajonale, duhet të vihet në dijeni drejtori i Përgjithshëm apo prefekti.

Raporti për Drejtorin e Përgjithshëm duhet të përmbajë edhe informacion për mënyrën e zbatimit të politikës së zyrës rajonale, performancën e personelit të punësuar në këtë zyrë, zbatimin dhe ndjekjen e buxhetit, zbatimin e detyrave dhe të përgjegjësive, të lëna nga Drejtori i Përgjithshëm, raportet e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion të Këshillit të Ministrave apo raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

11. Agjencia i ushtron funksionet e veta në përputhje me ligjin nr.9235, datë 29.7.2004, “Për

kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, si dhe me aktet e brendshme të Drejtorit të Përgjithshëm.

Të gjithë punonjësit e AKKP-së, që, sipas detyrës funksionale, pranojnë, ndjekin, plotësojnë, shqyrtojnë apo hetojnë, paraprakisht, kërkesat e subjekteve të shpronësuara apo përgatisin projektaktin a relacionin shoqërues, për çështje të shqyrtimit dhe vendimmarrjes së drejtorit të Përgjithshëm apo të Drejtorit të zyrës rajonale, sipas nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, kanë përgjegjësinë t’i dokumentojnë veprimet që kryejnë edhe në dosjen, ku regjistrohet kërkesa dhe vendoset dokumentacioni provues.

Evidentimi i veprimeve, në kuptim të këtij vendimi, kryhet nëpërmjet përfshirjes në dosje të çdo shkrese, që i bashkëlidhet praktikës, si dhe nëpërmjet depozitimit të të gjitha procesverbaleve, kujtesave, informacioneve, akteve të vlerësimit a ekspertimit, të përgatitura, sipas rastit apo çdo shkresë tjetër për të tretë apo të brendshme, për trajtimin e kësaj kërkesë. Në kuptim të këtij detyrimi, sektori juridik në zyrën rajonale apo/dhe sektori juridik në qendër, kanë përgjegjësinë ligjore të bëjnë vlerësimin e kërkesës dhe të rrethanave të paraqitura, për çështje të bazueshmërisë së saj në ligj dhe në prova. Vlerësimi ligjor është pjesë përbërëse e praktikës dhe nënshkruhet nga specialisti/ët jurist, që shqyrtoi/uan praktikën dhe përgjegjësi i zyrës ligjore, që e mbikëqyri dhe pranoi atë.

12. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ndjek dhe vë në dijeni, çdo muaj, Ministrin e Drejtësisë, për çështje të përfaqësimit të interesave ligjore të shtetit në gjykatë, gjatë zgjidhjes dhe shqyrtimit të konflikteve, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

13. Drejtuesi i zyrës rajonale dërgon në zyrën qendrore të agjencisë, brenda 7 ditëve kalendarike, një kopje të çdo akti administrativ, të marrë në përputhje me nenin 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, që i bashkëlidhet, sipas qarqeve, fondit arkivor. Ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit në AKKP në qendër dhe në zyrat rajonale, të kryhen në përputhje me ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”.

14. Personeli i AKKP-së duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i agjencisë. AKKP-ja rekruton personel, specialistë, të diplomuar në degët drejtësi, urbanistikë, arkitekturë, inxhinieri, specialistë për vlerësim pasurish të paluajtshme, ekonomistë, topografë dhe personel ndihmës. Marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

15. AKKP-ja financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donacionet e huaja.

16. Prefekti i çdo qarku, jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, mbikëqyr transferimin e arkivit, të logjistikës dhe të mjeteve të punës së zyrave rajonale dhe njofton me shkrim Kryeministrin për ecurinë e procesit. Transferimi të kryhet me procesverbal, për çdo dosje a praktikë të depozituar nga subjektet e shpronësuara. Kjo procedurë të zbatohet dhe për transferimin e çdo dosjeje nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në zyrën qendrore të AKKP-së.

17. Drejtori i Përgjithshëm bashkërendon punën në vijim me donatorët e huaj dhe organizatat ndërkombëtare për asistencën teknike në proces të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha